Krijimi i DPAC

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Keshilli i Ministrave

# VENDIM

Nr. 96 datë 21.2.1995

PËR

## KRIJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË AVIACIONIT CIVIL

Në zbatim të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 "Për aviacionin civil shqiptar", me propozimin e Ministrisë së Industrisë, të Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Të krijohet Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, si i vetmi autoritet aeronautik në vartësi të ministrit të Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, me qendër në Tiranë dhe emërtim të shkurtër DPAC.

2. Objekti i Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil të jetë përcaktimi dhe rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe personave juridikë e fizikë shtetërorë e privatë, në përputhje me interesat kombëtare dhe normat teknike ndërkombëtare të veprimtarive në fushën e aviacionit civil.

3. Drejtori i përgjithshëm dhe struktura organizative e kësaj drejtorie caktohet nga ministri i Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.

4. Shpenzimet e funksionimit dhe buxheti i kësaj drejtorie përballohen nga buxheti i shtetit dhe planifikohen nga Ministria

e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.

5. Paga e drejtorit të përgjithshëm dhe e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.492, datë 10.10.1994.

6. Ministri i Industrisë, Transportit dhe Tregtisë miraton rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ministri i Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

ALEKSANDËR MEKSI

Nr.prot.631

Datë 23.2.1995

PRESIDENCËS
KUVENDIT POPULLOR
GJYKATËS KUSHTETUESE
GJYKATËS SË KASACIONIT
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË INDUSTRISË, TRANSPORTIT DHE TREGTISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË PUNËS, EMIGRACIONIT, PËRKRAHJES SOCIALE DHE ISH TË PËRNDJEKURVE POLITIKË
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË SHTETIT

TIRANË

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

VULLNET ADEMI